



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3303/16 Prot.

Tiranë, më 24/12/2025

VENDIM
Nr.61, datë 24.12.2025

“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PERSONELIT AKADEMIK ME KOHË TË PJESSHME NË UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026”

Në përputhje Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë; me ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenet 47, 48, 49, neni 62; VKM-në me nr. 112, datë 23.2.2018, "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", e ndryshuar; VKM-në me nr. 329, datë 12.04.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik"; Udhëzimin nr. 36, datë 23.11.2018, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin nr. 29, datë 10.06.2018, Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar, kreu II, pika 8; Statutin e UBT-së të miratuar me Urdhrin nr. 586, datë 02.12.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, neni 15 pika n; Rregulloren "Për procedurat e rekrutimit për personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ në Universitetin Bujqësor të Tiranës" Kreu V, neni 14; Vendimin e Senatit nr. 26, datë 02.07.2018 "Mbi miratimin e rregullores së ciklit të tretë të studimeve – Doktoraturë", në vijim të praktikës të shpalljes për kriteret me nr. 3303 prot., datë 27.10.2025, si dhe në konsiderim të Vendimit të Rektoratit të UBT-së me nr.46, datë 13.11.2025; Vendimit të Senatit Akademik me nr.53 datë 17.12.2025, Bordi i Administrimit të Universitetit Bujqësor të Tiranës në mbledhjen e tij të datës 24.12.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë "Listën e personelit akademik me kohë të pjesshme për secilin Fakultet për vitin akademik 2025-2026", në total fitues 57 (pesëdhjetëeshtatë) kandidatë, bashkëngjitur listat.
 - a. Personelit akademik me kohë të pjesshme që do trajtohet financiarisht pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës është 43 (dyzetetre) kandidatë në total.
 - b. Personeli akademik i miratuar i cili po ndjek ciklin e studimeve "Doktoraturë" në total 14 (katërmëdhjetë) kandidatë të cilit nuk do të trajtohen financiarisht.

2. Referuar pikës 1.b, të vendimit Doktorantët do të nënshkruajnë një marrëveshje pa efekt financiar me titullarin e Universitetit Bujqësor të Tiranës, për rregullimin e marrëdhënies juridike mes tyre ku do të përcaktohen të gjithë termat dhe kushtet tekniko-ligjore, ne lidhje me angazhimin e tyre në mësimdhënie në programet e studimit të ciklit të parë sipas parashikimeve ligjore në Udhëzimin nr. 29, datë 10.06.2018, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar, kreu II, pika 8.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen, Dekanët e Fakulteteve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Juridike dhe Administratori i UBT-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Arta DOLLANI	Kryetar
Matilda SHABANI	Anëtar
Albert KOPALI	Anëtar
Edmond KADIU	Anëtar
Blerina DUKA	Anëtar
Altin PRENGA	Anëtar
Ilir KUSI	Anëtar

